



Planuar / Dërguar Punëpunë/Prodator Received/Delivery	04.05.2023	3	viti god year
Organ / Shërbim Organ / Shërbim Org./Unit	Nr. Prot. Pr. No.	Shtesa Punë Appendix	Sasia Koliciteti Quantity
SKIMSHCK	4047	2023	116



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.465/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Baraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.465/2023 të datës 07.03.2023, e parashtruar nga ankuesja me adresë:

kundër organit të punësimit/Autoriteti i Konkurrencës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.05.2023, mori këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.465/2023 e datës 07.03.2023, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 67/23-13/D i datës 14.02.2023 01-Nr.-016-47927 i Komisionit të Pranimin në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës.

### A r s y e t i m

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 02.12.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 23.12.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm me numër të referencës RN00010521 lidhur me pozitën "Asistent administrativ" në Departamentin Juridik dhe Administratës, për klasën e pozitës Profesional 3.

Ankuesja me datën 27.12.2022 ka aplikuar në konkursin e lartcekur, në të cilën procedurë ka qenë e përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit dhe pas intervistës me gojë, bazuar në renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës e gjeneruar tek SIMBNJ nga ana e organit të punësimit,

e njëjta është njoftuar lidhur me pikët e arritura, me gjithsejtë 65.4 pikë, duke u renditur e pesta (5) në listën përfundimtare.

E pakënaqur me rezultatet e vlerësimit lidhur me pjesën e jetëshkrimit nga ana e komisionit të pranimit, me datën 03.02.2023, ankuesja ka parashtruar ankesë tek organi i punësimit, me pretendimet ankimore se e njëjta do duhej të vlerësohej me pikët maksimale nga kjo fazë e vlerësimit bazuar në dispozitat e Rregullores 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Me datën 14.02.2023, Komisioni për Pranim përgjegjës për vlerësimin e procedurës së lartcekur në Autoritetin e Konkurrencës, ka nxjerrë vendimin sipas të cilit e njëjta edhe pse ka arritur pikët e nevojshme sipas rregullores në fuqi për të vazhduar fazën e intervistës, mirëpo që nuk ka arritur pikët e nevojshme për të qenë kandidatë fituese për pozitën në fjalë.

Ankuesja e pa kënaqur me vendimin e Komisionit të Pranimit në Autoritetin e Konkurrencës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 07.03.2023, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2440/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se është bërë diskriminim nga ana e komisionit lidhur me vlerësimin e jetëshkrimit ngase vlerësimi në këtë pjesë nuk ka qenë real.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 14.03.2023 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Autoriteti i Konkurrencës, ndërsa me datën 27.03.2023, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga kjo e fundit me shkresat e bashkëngjitura të lëndës

Me datën 19.04.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK/2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova Ankesën me numër protokollit 2440/2023 të datës 07.03.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Pasqyrën e llogarisë nga trusti për ankuesen për periudhën 14.12.2017-04.03.2022; Dokumentet relevante të ankueses me rastin e aplikimit sipas së cilës dëshmohet përvoja profesionale dhe ajo e punës bashkëngjitur me Diplomën Nr.2303 të datës 05.02.2020 nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Juridik lidhur me përfundimet e studimeve master; Diplomën Nr.4223 të datës 17.10.2016 nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Juridik lidhur me përfundimet e studimeve themelore; Certifikatën e datës 22.09.2020 nga Ministria e Financave; Letër referencën me numër Nr.ref 58/2019 të datës 04.04.2019 nga Ministria e Punëve të Jashtme; Kontratën e datës 01.07.2019 nga British Academy SH.P.K; Vërtetimin me numër Vr.Nr.1485/17 të datës 25.11.2017 nga Oda e Avokateve të Kosovës; Vendimin me numër 1498-1/2016 të datës 26.11.2016 nga Oda e Avokateve të Kosovës; Vërtetimin me numër Nr.157 të datës 12.12.2019 nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës; Vërtetimin me numër Nr.80 të datës 14.04.2021 nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës; Certifikatën me numër Nr.04 të datës 04.04.2016 nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës; Letër referencën nga Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë; Certifikatën nga Eipaa; Certifikatën nga Ora; Diplomën me numër 6210/13 të datës 12.04.2013 nga The Cambridge School; Diplomën me numër 926/05 të datës 07.06.2005; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.03.2023**

nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 27.03.2023 nga Autoriteti i Konkurrencës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Konkursin me numër të referencës RN00010521 të datës 02.12.2022; Listën e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar e gjeneruar në simbnj; Vendimin Nr.59/22 të datës 20.12.2022 lidhur me formimin e komisionit të pranimit; Akt emërimit me numër Nr.Prot.279/19-06/B të datës 01.10.2019 për Akt emërimit me numër Nr.Prot.432/18-04/B të datës 07.12.2018 për Akt emërimit me numër Nr.Prot.433/18-04/B të datës 07.12.2018 për ; Akt emërimit me numër Nr.Prot.430/18-04/B të datës 07.12.2018 për Akt emërimit me numër Nr.Prot.389/22-06/d të datës 20.12.2022 për emërimin e anëtarit të komisionit të pranimit në cilësinë e ekspertit të jashtëm; Renditjen përfundimtare të kandidatëve e gjeneruar tek simbnj; Komunikimin elektronik të datës 14.02.2023, 24.03.2023, 24.03.2023; Rezultatet e vlerësimit për ankuesen nga anëtarët e komisionit; Vendimin Nr.prot.67/23-13/D të datës 14.02.2023 të Komisionit të Pranimit; Ankesën e ankueses të datës 03.02.2023 e parashtruar tek Autoriteti Kosovare i Konkurrencës; Dokumentet relevante të kandidates se përzgjedhur me rastin e aplikimit sipas së cilës dëshmohet përvoja profesionale dhe ajo e punës bashkangjitur me Diplomën me numër të protokollit 383 të datës nga MASHT-Gjimnazi Xhevdet Doda-Prishtinë; Certifikatën me numër Ref.Nr.20/958 të datës 31.12.2015 nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Ekonomik; Certifikatën e datës 24.12.2009 nga NLB Prishtina; Letër referencën e datës 15.01.2010 nga Eorld Relief Kosovo-BZMF; Letër referencën e datës 05.01.2023 nga EIPP; Rezultatet e vlerësimit për kandidaten e përzgjedhur nga anëtarët e komisionit; Shkresën zyrtare lidhur mbi detajet konkursit në tërësi si dhe Vendimin VK/2023 të datës 19.04.2023 lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës së ankueses në Këshill.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar sepse:

Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit për emrin e grupit „Specialist i Administrimit të Përgjithshëm”, në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, i shpallur sipas konkursit me numër të referencës RN00010521 lidhur me pozitën “Zyrtar Administrativ” në Departamentin Juridik dhe Administratës, për klasën e pozitës Profesional 3, kanë qenë si në vijim:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet.*

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar nëntëdhjetë e gjashtë (96) kandidatë, ndërsa në listën e ngushtë janë përfshirë nëntëdhjetë e tre (93) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja e cila e ka kaluar fazën e verifikimit dhe ka marrë pjesë në testin me shkrim dhe intervistën me gojë, pasi që bazuar në listen mbi renditjen përfundimtare të kandidatëve lidhur me vlerësimin përfundimtar, e njëjta është njoftuar se ka arritur të grumbulloj gjithsejtë 65.4, prej nga rrjedh se ankuesja është vlerësuar nga Komisioni i Pranimit në pajtim me nenin 16 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është e përcaktuar se: “ 1.Vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Pranimit. i themeluar në pajtim me nenin 17 dhe/ose përkatësisht neni 18 të kësaj Rregulloreje. 2.Vlerësimi i kandidatëve, përfshin, sipas radhës: 2.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 2.2. vlerësimin e jetëshkrimit /CV, dhe 2.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë”.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon se gjatë këtij procesi ka pasur shkelje procedurale dhe ligjore gjegjësisht se komisioni i pranimit nuk i ka bërë vlerësim real dhe të drejtë pjesës së vlerësimit tek faza e jetëshkrimit sepse e njëjta është vlerësuar me 8.8 pikë ndërsa është dashur të vlerësohet me 20 pikë, Kolegji konstaton se në bazë të nenit 22 paragrafit 1, 2 dhe 4 nën paragrafit 4.1, 4.2, dhe 4.3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, që ka përcaktuar se: *"1.Pas testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me vlerësimin e jetëshkrimit. 2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën dyzet (40) pikë në testimin me shkrim, i nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit. 4.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri në njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri në tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin të arsimimit; 4.2. deri në shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet"*, ndërsa Komisioni i Vlerësimit në bazë të dokumentacioneve ka bërë vlerësimin e jetëshkrimit për të gjithë kandidatët ku ankuesja është vlerësuar me gjithsejtë 8.8 pikë, konkretisht tek pjesa *për cilësinë dhe nivelin e arsimimit ankuesi është vlerësuar me pikët maksimale*, andaj në këtë rast pretendimi i ankueses është i pabazuar sepse vlerësimi për këtë pjesë është bërë në mënyrë të drejtë. Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor se komisioni i pranimit ka vlerësuar kandidaten e përzgjedhur tek pjesa e jetëshkrimit me pikët maksimale prej 20 në këtë pjesë, Kolegji konstaton se pretendimet e ankueses janë të pa qëndrueshme sepse ankuesja nuk ka arritur që të argumentoj me asnjë provë dhe dëshmi se Komisioni i ka bërë vlerësim të padrejtë në krahasim me kandidaten e përzgjedhur apo kandidatët e tjerë në këtë proces të rekrutimit, respektivisht në bazë dëshmi të ofruara konkretisht Vendimit me numër protokolli 393/22-06/B të datës 20.12.2022 të Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës, ka konstatuar se Komisioni për Pranim pranë këtij institucioni lidhur me procedurën në fjalë është themeluar në pajtim me nenin 34 paragrafin 12, 13 dhe 14 të Ligjit Nr.06/L - 114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 17 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili konform këtyre dispozitave ligjore është i përgjegjës për zhvillimin e procesit të rekrutimit dhe se i njëjti është i pavarur sa i përket vlerësimit të kandidatëve, po ashtu në bazë të përgjigjes në ankesë të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës të datës 27.03.2023, është vërtetuar se të gjithë kandidatët në të gjitha fazat e rekrutimit janë vlerësuar drejtë dhe në pajtim me dispozitat ligjore duke filluar nga verifikimi paraprak deri tek përzgjedhja përfundimtare gjegjësisht nga vlerësimi i përgjithshëm, vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim, vlerësimi i jetëshkrimit, vlerësimi nëpërmjet intervistës me gojë e deri tek llogaritja e rezultatit përfundimtar, andaj Kolegji konstaton se vlerësimi i kandidatëve është zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 21 nenit 22, nenit 23 dhe të nenit 24 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ndërsa pretendimet ankimore të ankueses në këtë drejtim janë të pabazuara.

Kolegji, po ashtu ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore në Autoritetin Kosovaar të Konkurrencës ka publikuar Renditjen përfundimtare të kandidatëve e gjeneruar në sistemin SIMBNJ me numër lidhur me përfundimin e procedurës së rekrutimit për emrin e grupit *Specialist të Administrimit të Përgjithshëm* për pozitën *„Asistent administrativ"*, duke bërë renditjen përfundimtare sipas listës së rezultateve përfundimtare të kandidatëve me mbi 70 pikët e arritura, ndërsa si kandidate e suksesshme është përzgjedhur znj. \_\_\_\_\_ e cila ka arritur të grumbulloj gjithsejtë 72.4 pikë të përgjithshme, andaj Kolegji konstaton se publikimi është bërë në pajtim me nenin 9 dhe paragrafin 2 të nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sipas së cilës përcaktohet se: *"2.Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues"*, dhe ndërlidhur me këtë rast ankuesja është renditur e pesta (5) me gjithsejtë 65.4 pikë të përgjithshme, që në rastin konkret ankuesja në bazë të kësaj dispozite nuk ka arritur të grumbulloj mbi 70 pikë të nevojshme për përzgjedhje si kandidate e suksesshme bazuar në dispozitën në fjalë.

Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara lidhur me dosjen e kandidatës së perzgjedhur në fjalë dhe ka konstatuar se Komisioni i Pranimit me rastin e perzgjedhjes së kandidatës për emrin e grupit *Specialist të Administrimit të Përgjithshëm* për pozitën „Asistent administrativ”, në Departamentin Juridik dhe Administrates në kuader të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës si kandidatë e cila ka grumbulluar më së shumti pikë të përgjithshme me gjithsejtë 72.4 pikë, ka vepruar në pajtim me nenin 21, 22, 23 dhe 24 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: „... *Shuma e pikëve të përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, japin vlerësimin përfundimtar të kandidatit*”, e cila në bazë të dëshmimeve lidhur me përvojën profesionale ka dorëzuar Certifikatën me numer Nr.20/958 të datës 31.12.2015 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Ekonomik sipas së cilës dëshmohet se me datën 31.12.2015 i ka përfunduar të gjitha provimet e parapara në studimet themelore në Departamentin-Banka, Financa dhe Kontabilitet dhe me këtë rast ka marrë titullin si “Bachelor për banka, financa dhe kontabilitet”, ndersa ndërlidhur me përvojën e punës meqenëse nuk është kërkuar në këtë konkurs, Kolegji nuk është lëshuar fare në vlerësimin e së njëjtës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Zyra e Personelit në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës me rastin e publikimit të rezultateve përfundimtare sipas formularit të nxjerrë nga Komisioni për Pranim dhe Raportit përmes sistemit tek SIMBNJ lidhur me rezultatet finale për pozitën: “Asistent administrativ”, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.6/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe nenin 25 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se Komisioni për Pranim në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokollit 67/23-13/D të datës 14.02.2023 për ankesën e ankueses së datës 03.02.2023, ka vepruar në pajtim me dispozitat Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse është vërtetuar drejtë gjendja faktike dhe konstatuar saktë baza juridike, sipas së cilës edhe është refuzuar e njëjta.

Andaj Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se procedura e konkursit sipas njoftimit të datës 02.12.2022 e shpallur për aplikim nga data 23.12.2022-06.01.2023, për emrin e grupit „Specialist të Administrimit të Përgjithshëm” lidhur me pozitën „Asistent administrativ”, në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, me numër reference RN00010521 është zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 34 paragrafit 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.465/2023, datë 04/05/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës;
- Udhëheqësit të Personelit në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.